c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;



4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

**d)** Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

| <b>1</b>  | <b>2</b>                     | <b>3</b>               |
|-----------|------------------------------|------------------------|
| <b>Nr</b> | <b>Përshkrimi i mallrave</b> | <b>Norma e fitimit</b> |
|           |                              |                        |

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

## Lista e Cmimeve

| Nr | Emertimi          | Njesia | Sasia | Cmimi pa tvsh | Vlera pa tvsh |
|----|-------------------|--------|-------|---------------|---------------|
| 1  | Biskota Bebe      | pako   | 300   |               |               |
| 2  | Buke              | cope   | 1,900 |               |               |
| 3  | Djathe            | kg     | 50    |               |               |
| 4  | Fasule            | kg     | 230   |               |               |
| 5  | Gjalp             | kg     | 280   |               |               |
| 6  | Gjalp soft 400 gr | cope   | 230   |               |               |
| 7  | Koncentrat pule   | pako   | 305   |               |               |

|    |   |        |       |  |  |
|----|---|--------|-------|--|--|
| 8  | Kripe                                   | kg     | 29    |  |  |
| 9  | Leng limoni                             | cope   | 20    |  |  |
| 10 | Maja buke 125 gr                        | cope   | 50    |  |  |
| 11 | Makarona rruze                          | kg     | 940   |  |  |
| 12 | Makarona supe                           | kg     | 520   |  |  |
| 13 | Miell                                   | kg     | 395   |  |  |
| 14 | Cokokrem                                | cope   | 250   |  |  |
| 15 | Oriz                                    | kg     | 950   |  |  |
| 16 | Perime te ngrira                        | pako   | 131   |  |  |
| 17 | Qepe                                    | kg     | 150   |  |  |
| 18 | Qumesht I fresket                       | kuti   | 2,400 |  |  |
| 19 | Salc domatesh 90 ml                     | cope   | 100   |  |  |
| 20 | Sheqer                                  | kg     | 140   |  |  |
| 23 | Shtesa per gjell dhe perime pako 500 gr | pako   | 86    |  |  |
| 21 | Sode buke 100 gr                        | pako   | 40    |  |  |
| 22 | Vaj                                     | cope   | 365   |  |  |
| 24 | Veze                                    | kokrra | 3,800 |  |  |
|    | <b>Shuma pa tvsh</b>                    |        |       |  |  |
|    | <b>Tvsh %</b>                           |        |       |  |  |
|    | <b>Shuma me tvsh</b>                    |        |       |  |  |

---

|   |  |
|---|--|
| <b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b> |  |
| <b>Nënshkrimi</b>                         |  |
| <b>Vula</b>                               |  |
| <b>Datë</b> _____                         |  |

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |
|   |   |  |  |

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

#### Shtojca 5.

---

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimet për produktet që kerkohen të prokurohen

### **“BUKE GRURI”**

**Bazuar në STASH 1411\87**

#### **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

- Lloji: bukë gruri me miell me rreze 75 %.
- Korja: e lëmuar, pa flluska, pa çarje e pjesë të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tuli. Me ngjyrë të njëllojtë mjalti në të kuqërremtë.
- Tuli: masë e njëllojtë e pjekur mirë, jo e ngjithshme me pofre të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme dhe pa gjurmë mielli të pa brumosur.
- Kosinsienca elastike me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e parë jo i thërmueshëm dhe pa shtresa.
- Era dhe shija: e këndshme e bukës së pjekur mirë. Pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj. Nuk lejohet kërcitje.
- Forma: e rregullt pa shtypje e deformime.
- Lëndë të huaja: nuk lejohen.

---

### **TREGUESIT “Fiziko- kimikë”**

- Lagështira: jo më shumë se 45 %.
- Poroziteti: jo më shumë se 70 %.
- Aciditeti: jo më shumë se 4. 5<sup>0</sup>
- Buka dërgohet për konsum jo më pare se 3 orë nga koha e pjekjes.
- Masa e caktuar sipas llojit të bukës duhet ti përgjigjet masës 3- 4 orë mbas kohës së pjekjes.

### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- Amballazhimi: buka amballazhohet në kuti plastike të lejuara për produkte ushqimore.
- Transporti i bukës: bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno- sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

### **“QUMESHT”**

### **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

- Lloji: qumësht për konsum, i freskët.
- Pamja e jashtme: të jetë lëng homogjen, pa lëndë të huaja që notojnë apo precipitojnë.
- Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.
- Ngjyra: e bardhë e njëllajtë, nuance e lehtë e verdhë.
- Shija dhe era: të këndshme, lehtësisht e ëmbël, shije e lehtë zierjeje, pa shije ose erë të huaja.
- Gjatë përpunimit dhe tregëtimit të zbatohen rregullat higjeno- sanitare e veterinare në fuqi.
- Nuk duhet të lejohet pëdorimi i lëndëve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.

### **TREGUESIT “Fiziko- kimikë”**

- Dendësia: në 20<sup>0</sup>C, jo më pak se 1. 029<sup>0</sup>C
- Yndyra: 2 %
- Lëndë të thata (pa yndyra): jo më pak se 8. 5 %.
- Prova e pasterizimit (e fosfatazës dhe peroksidezës): dhet negative.
- Pastërtia pa mbetje me site mëndafshi apo merle pambuku dyfishe.

### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- Ruajtja e transportimit: në temperaturë 2- 8<sup>0</sup>

### **MARKETIMI**

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Peshë neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.
- Ngarkesa mikrobike sipas nomave të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë.

### **“DJATHE I BARDHE”**



---

## **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

- Lloji: djathë fete, cilësi e parë.
- Të jetë i stazhionuar jo më pak se 45 ditë, të mos jetë i falsifikuar me niseshte apo lëndë të huaja.
- Ngjyra: e bardhë.
- Forma: prizëm, trekëndësh me një faqe enësore cilindrike. Masa e formës: 2- 3 kg.
- Era dhe shija: e këndshme, specifike e djathit të butë të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije e erë të huaj.
- Pamja e jashtme dhe e brendshme: e formuar mire, e pastër dhe pa njolla.
- Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe.
- Në prerje është e njëllotë, e pastër, pa lëndë të huaja me sythe teknike, me ngjyrë të bardhë deri në krem.
- Struktura dhe konsistenca: e lëmuar, jo e fortë dhe pa dallim shtresash.

## **TREGUESIT “Fiziko- kimikë”**

- Yndyra në lëndët e thata: jo më pak se 50 %.
- Kripë: 4- (-1) %.
- Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- Në çdo parti djathi lejohen deri në 5 % copa dhe 2 % thërrime, masa e një cope më e madhe ose e barabartë me 50 gr.
- Ruajtja: në frigorifer për 12 muaj në temperaturë nga 3- 5<sup>0</sup>, lagështira e ajrit: 95 %.
- Malli të shoqërohet me fletë analizë.

## **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- Amballazhimi: brenda kushteve higjieno- sanitare, me peshë sipas kërkesave të Entit.
- Djathi në vozë qëndron i mbuluar me shëllirën fillestare, e cila përmban 10- 14 % kripë deti.
- Etiketa e produktit të amballazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga amballazhi.
- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e amballazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike për pikë si të etiketës origjinale.

## **MARKETIMI**

- Emërtimi i prodhuesit

- 
- Emri i produktit
  - Pesha neto ose vëllimi i produktit
  - Data e prodhimit
  - Kushtet e veçanta të ruajtjes.
  - Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

### **“GJALP”**

#### **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

- Lloji: gjalp i freskët dhe me kripë, cilësi e parë.
- Pamja e jashtme: e njëtrajtshme pa shtesa në prerje me sipërfaqe të shndritur pa pika uji dhe mbeturina dhalli.
- Ngjyra: gjalp i freskët, krem deri në të verdhë të çelur. Gjalp i kripur, ngjyra e bardhë deri në të verdhë, karakteristike e kremës nga e cila prodhohet e njëllotje në të gjithë masën.
- Era dhe shija: gjalp i freskët shije e këndshme karakteristike e gjalpmit të freskët, pa shije të huaj. Gjalp i kripur, erë e këndshme, karakteristike e gjalpmit, lehtësisht e kripur pa erë të huaj.

#### **TREGUESIT “Fiziko- kimikë”**

- Lgështira: jo më shumë se 17 %.
- Lëndë të thata pa yndyrë: jo më shumë se 2 %.
- Kripë: jo më shumë se 2 % gjalpi i kripur.
- Aciditet: jo më shumë 3 gr gjalpi i freskët dhe jo më shumë se 5 gr gjalpi i kripur.
- Ngarkesa mikrobike brenda normave të lejuara nga Ministria e Shëndetësisë.
- Konsistenca: në temperaturën 10- 12 °C, gjysëm e fortë.

#### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- Amballazhimi: gjalpi i freskët dhe i kripur amballazhohet në kuti kartoni të valëzuar me masë 0.5- 5 kg (sipas kërkesës së Entit), të veshur nga brenda me letër pergamen.
- Etiketa e produktit të amballazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga amballazhi.
- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e amballazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga amballazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike për pikë si të etiketës origjinale.

- 
- Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

### **RUAJTJA DHE TRANSPORTIMI**

- Gjalpi ruhet në rigotifer në temperaturë 2- 4<sup>0</sup>C.
- Transportimi i gjalpfit nga një rreth në tjetrin bëhet me mjete frigoriferike. Ndërsa brenda rrethit, lejohet transportimi i tyre me mjete të zakonshme të mbuluara e të pastra, të cilat janë të destinuara për transportimin e prodhimeve ushqimore.

### **MARKETIMI**

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

### **“QEPE E THATE”**

#### **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

- Pamja e jashtme: me pjekuri të plotë, me cipë e bisht të thatë, të shëndosha e të plota.
- Ngjyra dhe forma: me ngjyrë e formë tipike të kultivarit dhe me gjatësi deri në 7 cm.
- Diametri: për ovalet 4- 8 cm dhe për llojet e tjera 5- 10 cm.

#### **DEMTIME MEKANIKE NUK LEJOHEN**

- Cifla, bishta lejohen jo më shumë se 1 %, me dëmtime të lehta.
- 1 % lëndë të huaja (çifla, bishta).
- Me sëmundje nuk lejohen.
- Të ngrira, të kalbura e të mykura nuk lejohen.

#### **LEJOHET**

- Lejohet furnizimi me qepë të thata të thurua në vargje me gjatësi të ndryshme.
- Pesha e materialit që përdoret për thurje në vargje të mos kalojë 6 % të masës së përgjithshme.

#### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik përkatën në fuqi.
- Qepa e thatë ambalazhohet edhe në thasë.
- Qepa e njomë dhe preshi lidhet në tufa në dy vende dhe këto vendosen në arka tip.
- Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastëra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno- sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.
- Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë

---

## MARKETIMI

- Firma prodhuese
- Lloji i prodhimit
- Cilësia
- Masa neto dhe bruto

### “PATATE” (STASH 1729/88)

## TREGUESIT “Organo- Leptikë”

- Lloji: patate verore dhe dimërore
- Pamja e jashtme: të plota, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jot ë mbira.
- Ngjyra: me ngjyrë dhe me sytha tipike të kultivarit.
- Pjekuria: kokrra të pjekura
- Të pastra në sipërfaqe me formë, ngjyrë e sytha tipike të kultivarit.
- Diametri - për të rrumbullaktat dimërore (5 cm), dhe verore (4 cm)
  - për vezaket dimërore dhe verore (4 cm)
  - për të zgjaturat (3.5 cm)

## LEJOHEN

- Lehtësisht të gjelbërta, jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 1 % për veroret.
- Të mbira, jo më shumë se 1 %.
- Lehtësisht të vyshkura, jo më shumë se 3 % për dimëroret dhe 2 % për veroret.
- Zgjebe me plagë deri në 1/5 e sipërfaqes së kokrrës, jo më shumë se 1 %.
- Dëmtime nga krimbi, jo më shumë se 1 %.
- Kokrra të pjekura për patatet verore lejohen me lëkurë që hiqen.

## NUK LEJOHEN

- Nuk lejohen patate verore të mbira.
- Të çara, të prera e të plasura nga goditjet, nuk lejohen.
- Të kalbura nga lagështira vetëngrohja, bryma, ngrica, nga sëmundje e dëmtues, nuk lejohen.
- Njolla boje hiri e ndryshkur deri në 1/5 e sipërfaqes së kokrrës, nuk lejohen.
- Dëmtime nga doseza, nuk lejohen.
- Për patatet dimërore nuk lejohen që lëkura të ndahet nga tuli.

## AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI

- Perimet amballazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik përkatën në fuqi.
- Patatja amballazhohet edhe në thasë.
- Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastëra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno- sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

- 
- Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë

#### **MARKETIMI**

- Firma prodhuese
- Lloji i prodhimit
- Cilësia
- Masa neto dhe bruto

#### **“FASULE”**

#### **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

- Pamja e jashtme: kokrra të plota, të shëndosha, me formë dhe madhësi sipas llojit (ovale, e rrumbullakët, e gjatë, etj) me gjatësi 8- 13 mm.
- Ngjyra: e bardhë.
- Era dhe shija: pa erë myku dhe çfarëdo ere tjetër të huaj. Pas zierjes të ketë erë të këndshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo ere tjetër të huaj.

#### **TREGUESIT: “Fiziko- Kimikë”**

- Lagështira: 11. 2 %.
- Lëndë të huaja: jo më shumë se 0. 8 %.
- Kokrra të thyera: jo më shumë se 13 %.
- Përzierje kokrrash: jo më shumë se 2. 2 %
- Dëmtime mekanike nuk lejohen.
- Infeksione ose dëmtime nga insektet nuk lejohen.

#### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- Amballazhimi i pakëtuar me peshë 1 kg.
- Malli të jetë i shoqëruar me etiketën e cilësisë (me datën e prodhimit dhe skadencës deri në 1 vit)

#### **MARKETIMI**

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Peshë neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të nmdjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
- Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit

#### **“SHEQER”**

#### **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

- 
- Pamja e jashtme: Pluhur i përbërë nga kristale të imta dhe të njëjta, pa lëndë të huaja, i derdhur, i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet.
  - Ngjyra: E bardhë dhe me shkëlqim.
  - Shija dhe era: Shije e ëmbël, pa shije dhe erë të huaj kur është kristal dhe kur tretet në ujë të pastër.
  - Tretshmëria: Të tretet plotësisht në ujë, tretësira e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

### **TREGUESIT “Fiziko- kimikë”**

Treguesit teknikë:

1. Lagështira: 0. 074 %
2. Polarizimi: 99. 62 %
3. Hiri: Jo më shumë se 0. 07 %
4. Lëndë reduktuese (Sheqer invert): jo më shumë se 0. 1 %

### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

1. Amballazhimi: I paketuar me pako letre me peshë 1 kg, i etiketuar.

### **MARKETIMI**

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të nmdjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.

### **“VAJ VEGJETAL LULE DIELLI (STASH 2121- 87)**

#### **TREGUESIT “Organo- leptikë ”.**

1. Pamja në 20<sup>0</sup> C: Lëng vajor, i qartë pa depozitime
2. Ngjyra: E verdhë e lehtë
3. Era dhe shija: E mirë, karakteristike e vajit lule dielli, pa shije dhe erë të huaj e të ranciduar.

#### **TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”**

1. Aciditeti: Jo më shumë se 0. 4 mg KOH/ gr Vaj ose në Acid Oleik 0. 2 KOH/ gr / 100 gr vaj.
2. Lagështia dhe lëndët fluturuese në 105<sup>0</sup> C: jo më shumë se 20 %
3. Dendësia relative në 20<sup>0</sup> C: 0. 918- 0. 923 %
4. Numri i sapunifikimit (mg KOH/ gr vaj 188- 194)

- 
5. Treguesit e refraksionit: 1467- 1469
  6. Treguesi i jodit: 110- 143
  7. Lëndë të pasapunifikueshme: jo më shumë se 15 gr/ kg

#### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

1. Vaj lule dielli i rafinuar do të ambalazhohet në shishe plastike me vëllim 1 ose 5 litroshe, të mbyllura me tapë plkastike me vidhëzim hermetic të kapsuluara me shirit PVC me stampën përkatëse.
2. Mbi çdo shishe do të vendoset etiketa në të cilën do të shënohet emërtimi i plotë i mallit dhe data e prodhimit.

#### **MARKETIMI**

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi amballazh ose mbi etiketë.
8. Data e skadimit ose afati I përdorimit që do të jetë 18 muaj nga data e prodhimit dhe e urnizimit në institucion.
9. Shishet do të ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mire.
10. Malli të shoqërohet me çertifikatë dhe raport analizë të laboratorit.

#### **“MAKARONA”**

#### **TREGUESIT “Organo- leptikë”**

1. Forma: makarona rruaze dhe makarona për supë me forma të ndryshme.
2. Pamja e jashtme: Në formë të rregullt, të plota me sipërfaqe të lëmuar deri lehtësisht të ashpër.
3. Pas zierjes, makaronat të jenë elastike, të mos qulloren, të mos çahen dhe të mos krijojnë shkumë.
4. Ngjyra: E bardhë, me nuance të verdhë, në thyerje qelqore me jo më pak se gjysma e sipërfaqes së seksionit.
5. Era dhe shija: E mirë, karakteristike e makaronave pa shije të hidhur, të thartë, të mykur dhe pa çfarëdo ere dhe shije tjetër të huaj.

#### **TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”**

1. Lagështia: jo më shumë se 13 %
2. Aciditeti: Acid Sulfurik jo më shumë se 0.16 %
3. Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se 2 herë.
4. Insekte dhe dëmtues të tjerë nuk lejohen.

#### **AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- 
1. Makaronat të jenë të ambalazuara me qese polietileni nga 0.5- 1 kg, me etiketë ku të shënohen standartet, të mos jenë të miellzuara.
  2. Të tregohet koha e zierjes dhe të shënohen standartet.

### **MARKETIMI**

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Peshë neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

### **“ORIZ”**

### **TREGUESIT “Organo- leptikë” (Kategori I.)**

1. Pamja e jashtme: Kokrra të shëndosha, të pastra, të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shije dhe erë myku ose prishje.
2. Ngjyra: e bardhë, lejohen kokrra me nuance ngjyre të verdhë.
3. Era dhe Shija: Karakteristike e orizit të shëndoshë pa shije të thartë, të hidhur, pa erë të mykur dhe erë tjetër të huaj.

### **TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”**

1. Lagështia: 12.8 %
2. Aciditeti 0.081 %
3. Lëndë të huaja: jo më shumë se 0.4 %
4. Kokrra të thyera më të vogla se gjysma jo më shumë se 12 %
5. Lëndë minerale nuk lejohen
6. Kokrra të verdha jo më shumë se 4 %
7. Kokrra të pazhveshura nuk lejohen
8. Të mos përmbajë dëmtues të gjallë ose të ngordhur

### **AMBALLAZHIMI DHE ETIKETIMI**

1. Ambalazhimi duhet të jetë i paketuar në qese, me peshë 1 kg, i etiketuar, me afat skadimi deri në 1 vit, i shoqëruar me fletë analiza
2. Orizi i cilësisë së parë duhet të ketë më pak se 30 % të kokrrave të copëtuara, të mos jenë të miellzuara.

### **MARKETIMI**

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Peshë neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës



- 
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
  7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

#### **“VEZE PULE”**

#### **TREGUESIT “Organo- Leptikë”**

1. Pamja e jashtme: e pastër dhe pa plasje. Lejohenm ndotje të lehta
2. Dhoma e ajrit (lartësia), jo më shumë se 9 mm
3. E bardha e vezës: e dendur, e kulluar dhe e pastër pa njolla gjaku (të kontrolluar në ovoskop)
4. E verdha e vezës: Kompakte e ndodhur në pozicionin qëndror pak e lëvizshme. Lejohet devijim i vogël nga pozicioni qëndror.
5. Era: pa erë prishjeje dhe erë tjetër të huaj
6. Masa: jo më pak se 40 gr

#### **AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI**

1. Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila dhe në çdo kuti kartoni vendosen 12 copë kartona fole.
2. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shënohen:

#### **MARKETIMI**

1. Emërtimi i ndërmarrjes prodhuese
2. Sasia
3. Data e prodhimit

**“KRIPE E JODIZUAR” (STASH 1437/ 01. 07. 1995)**

#### **TREGUESIT “Organo- leptikë”**

1. Lloji: kripë ushqimore përpunuar dhe e bluar për përdorim në guzhinë.
2. Ngjyra: e bardhë
3. Era dhe shija: e kripur pa shije dhe erë të huaj
4. Pamja; masë kokrrizore

#### **TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”**

1. Imtësia: 0. 2- 2 mm
2. Klorur Na në lëndën e thatë: jo më pak se 98 %
3. Klorur Mg në lëndën e thatë, jo më shumë se 0. 3 %
4. Sulfat Mg në lëndën e thatë, jo më shumë se 0. 9 %
5. Sulfat Ca në lëndë e thatë, jo më shumë se 0. 2 %
6. Lëndë të patretshme në lëndën e thatë, jo më shumë se 0. 3 %
7. Lagështirë: jo më shumë se 1 %
8. Jodur kaliumi: 50+ -3 mg/ kg
9. Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno –shëndetësore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

---

## **AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI**

1. Ambalazhimi të bëhet në qese të pastër ose polietileni ushqimore, pasha 0.5- 1 kg.
2. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.
3. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
4. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
5. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
6. N.q.s gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar, duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
7. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër, shënimet e detyrueshme duhet të jenë pike për pike si të etiketës origjinale.
8. Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

## **MARKETIMI**

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Peshë neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë

## **“SODE BUKE” (STASH 1429- 87)**

### **TREGUESIT “Organo- leptikë”**

1. Pamja e jashtme: me sipërfaqe të njëjlojtë ku nuk lejohen shenja myku dhe fermentimi, pa fara dhe pjesë të fermentuara.
2. Ngjyra: e kuqe, e njëjlojtë, karakteristikee zarzavatit të përdorur e të ziera.
3. Shija dhe era: me erë të pëlqyeshme, karakteristike e zarzavatit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

### **TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”**

1. Përmbajtja e ekstratit të dobishëm: 28 %
2. Aciditeti: jo më shumë se 0.1 %
3. Kripë NaCl: jo më shumë se 1.3 %

## **AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI**

- 
1. Amballazhimi: të jetë i ambalazhuar hermetikisht në shishe qelqi, me peshë 720 gr, me etiketë ku të jenë të shënuar standartet.

#### **MARKETIMI**

2. Emërtimi i prodhuesit
3. Emri i produktit
4. Pesha neto ose vëllimi i produktit
5. Data e prodhimit
6. Data e skadencës
7. Kushtet e veçanta të ruajtjes
8. Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

#### **“MIELL GRURI” (STASH 1455/ 87)**

#### **TREGUESIT “Organo- leptikë”**

1. Lloji: miell gruri me rreze 80 %
2. Ngjyra: e bardhë me nuance të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit.
3. Pjesëzat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.
4. Era dhe shija: erë karakteristike e miellit të grurit, pan erë myku, pa shije të hidhur, të thartë dhe pa erë e shije të huaj. Nuk lejohen kërcitje.

#### **TREGUESIT “Fiziko- Kimikë”**

1. Lagështira: jo më shumë se 14 %
2. Aciditeti: i shprehur në acid sulfurik absolutisht të thata, jo më shumë se 0.115.
3. Hiri: i tretshëm në acid klorhidrik 10 %, në lëndën absolutisht të thatë, jo më shumë se 0.1 %.
4. Mbisitja (imtësia e bluarjes): për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra; në sitën metalike nr. 54 jo më shumë se 2 % dhe në sitën e mëndafshtë, jo më shumë se 5 %.
5. Gluteni i njomë, jo më pak se 25 %
6. Lëndë minerale: nuk lejohen
7. Përzierje metalike: plumbi, zinku e bakri nuk lejohen.
8. Lejohet përmbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, jo më shumë se 3mg. g
9. Mikroorganizma patogjene, infestime dhe dëmtues hambari të gjallë nuk lejohen.

#### **AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI**

1. Amballazhimi: në pako letre me peshë 1 kg. Mbi amballazh vendoset etiketa ku të shënohen standartet.
2. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga amballazhi.
3. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pëlqyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

- 
4. N. q. s është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
  5. Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferikë duke zbatuar rregullat higjeno- sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

## **MARKETIMI**

1. Emërtimi i prodhuesit
2. Emri i produktit
3. Pesha neto ose vëllimi i produktit
4. Data e prodhimit
5. Data e skadencës
6. Kushtet e veçanta të ruajtjes.
7. Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

### **“MAJA BUKE”**

Ngjyra dhe era karakteristike e majase se bukes ,e njetrajtshme pa njolla,pa lende te huaja pluhur

#### **Ambalazhimi**

- Ne pako letre me peshe 125 gr.Mbi ambalazh te vendoset etiketa ku shenohen te dhenat e meposhtme
- Emertimi I prodhuesit
- Emertimi I produktit
- Pesha neto ose vellimi I produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit

### **“ÇOKOKREM”**

Te jete cilesi ekstra, mase homogjene ne trajte kremi me kakao, lajthi dhe qumesht pluhur, pa konservues. Perberesit: Qumesht pluhur, sheqer, yndyrna 26% kakao , lajthi 10 – 12%.  
Ambalazhimi hermetik me vazo plastike me peshe 1 kg me etikete

### **“PERIME TE NGRIRA”**

Perimet e ngrira per supa te ndryshme , te kene ne permbajtjen e tyre bizele, karrota, miser, patate. Te jene ne paketime 450 gr. Ne ambalazhim te jete shenuar pesha neto ose vellimi I produktit, data e prodhimit, data e skadimit

### **“KONCETRAT PULE”**

---

Te jene ne pako me 8 tableta brenda, te mos kete mase lageshtire, te jene ruajtur ne vende te fresketa. Ne ambalazhim te jete shenuar pesha neto ose vellimi I produktit, data e prodhimit, data e skadimit

**“SHTESE PER GJELLE DHE PERIME”**

Te kete ne permbajtjen e saj ereza, kripe. Te jete ne paketime 500 gr. Te jete ruajtur ne ambjente pa lageshtire. Ne ambalazhim te jete shenuar pesha neto ose vellimi I produktit, data e prodhimit, data e skadimit

---

Shtojca 6

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

## **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet:**

**Afatet e lëvrimit: Sipas nevojave të Autoritetit kontraktor**

---

## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim shtojca 7.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021,2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së Fondit Limit.

2.2.2. Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të tre viteve të fundit 2020 , 2021, 2022 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit . Shenim: Ne respektim të VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e



---

rregullave të prokurimit publik”, neni 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëqë dy bilanci të njëpasnjëshme nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023, në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së. (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

*\* Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit dokumentin e lartpërmendur.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- certifikatën ISO 22000:2018 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së ushqimore (e vlefshme), ose ekuivalente të tyre
- certifikatën ISO 9001:2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë (e vlefshme), ose ekuivalente të tyre.

---

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashket të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesi vertetim për numrin mesatar të punonjësve për periudhën kohore Tetor 2023 – Dhjetor 2023 jo më i vogël se 2 punonjës, i vertetuar nga organet tatimore për të mundur realizimin e kontratës me sukses.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve .
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) mjet transporti, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronësie ose kontrate qeraje noteriale), leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, lejet e drejtimit të drejtuesit të mjetit

\* *Kriteret për disponimin e mjeteve dhe punonjësve do të konsiderohen të përmbushura gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbljedhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit dokumentat e lartëpërmendura.*

*Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbljedhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.*

### **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**3.** Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë, ai duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli I fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet conform kërkesave ligjore.

---

Operatori ekonomik I shpallur fitues perpara lidhjes se kontrates ka detyrimin te paraqese dokumentacion provues, ku te provohet se nga kontrolli I fundit i AKU ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet conform kerkesave ligjore.

\* *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e vetëdeklarimit, referuar në Rekomandimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik nr.10181 prot.datë 19.11.2018 dhe Autoriteti Kombëtar të Ushqimit nr.8514 prot.datë 19.11.2018 “Mbihartimin e kriterëve të veçanta për kualifikimin dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, kreu III, pika “g”. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.*

Shënim: Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë fizikisht pranë Bashkisë Bulqize dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

*Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.*

